**VENDIM**
**Nr. 328, datë 14.6.2023**

# PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 271, DATË 25.5.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, "PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË TË RIORGANIZUAR"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja "ë", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 13 dhe 66, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenin 44, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Në nenin 7, të vendimit nr. 271, datë 25.5.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar" bëhet ky ndryshim dhe shtesë si më poshtë:

a) pas togfjalëshit "Gjykata Administrative" nyja e përparme "*të*" ndryshon dhe zëvendësohet me nyjën e përparme "*e*";

b) pas togfjalëshit "Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë" duhet shtuar togfjalëshi "*brenda muajit korrik 2023,*",

pra neni 7 i vendimit të sipërcituar ndryshon si më poshtë:

"*Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, brenda muajit korrik 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja, në datën 30.6.2023, e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër.*".

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
**Naureda Llagami**